



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures


Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin

Nëntor, 2022

Takimet e rregullta me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve
Qëndrime unike për përballje me sfidat e kohës



Edhe në muajin nëntor janë mbajtur takime e konsultime të rregullta me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve për të bashkëbiseduar për çështje me rëndësi dhe për të marrë vendime të përbashkëta lidhur me angazhimet dhe aktivitetet e përditshme. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë dhënë informacione lidhur me situatën aktuale dhe për sfidat e paraqitura gjatë muajit nëntor. Pas kësaj pjesëmarrësit në ...(faqe 4)

Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takuan me zv/ministrin Pupovci

Bashkëbisedë për situatën aktuale në arsim



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Duke dëshmuar se i kushton rëndësi meritore dialogut, SBASHK-u i ka dërguar ftesë për ...(faqe 4)

SBASHK zhvilloi aktivitete në Skenderaj e Suharekë
U rifillua me trajnimet bazuar në kërkesat e anëtarësisë



Kërkesat e arritura nga koleget dhe kolegët ...(faqe 5)


Takim i SBASHK-ut me
Sindikatat e arsimit të
Maqedonisë dhe Shqipërisë

**Gatishmëri për aktivitete të
përbashkëta sindikale**

Qendra Amerikane e
Solidaritetit me seli në Tiranë
vazhdon me angazhimet me
qëllim që të ndihmojë...(faqe 6)

Intervistë me mësimdhënësen
dhe veprimtaren sindikale Nora
Ajeti

**Klasa nuk do të ishte një
vend edukimi pa një mësues
të mrekullueshëm**



Nora Ajeti është mësimdhënëse
në shkollën ...(faqe 3)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Në 110 vjetorin e Flamurit kombëtar



Nëntori i vitit 2022 riktheu kujtesën në datat dhe ngjarjet e rëndësishme të kombit tonë.

Qytetet dhe fshatrat kudo në trojet etnike morën pamje feste më 28 nëntor dhe aktivitetet e shumta kulturore shprehën krenarinë për ditën e flamurit dhe respektin e përjetshëm për luftëtarët dhe emrat emblemë të historisë sonë.

Shkollat dhe shumë ambiente të tjera morën pamje festive me flamurin kombëtar dhe me fotografitë e emrave të shquar të historisë sonë. Këto pamje rikthenin kujtesën për angazhimet e vazhdueshme të

bijve e bijave të kombit, që me veprat e tyre sublime ishin në ballë të përpjekjeve për pavarësi e liri. Mijëra qytetarë vizituan edhe Prekazin e historisë për të dëshmuar respektin e krenarinë për komandantin legjendar Adem Jashari dhe për gjithë luftëtarët e lirisë, që me emblemën e UÇK-së e nëpër beteja trimërie larguan errësirën dhe sollën rrezet e lirisë për Kosovën e larë me gjak nëpër vite e dekada.

Ky nëntor shënoi 110 vjetorin e pavarësisë dhe rrugëtimin nëpër furtuna të kombit tonë për të arritur deri te ditët e festave dhe të buzëqeshja e fëmijëve dhe kënga e tyre për dëshmorët e kombit.

Kudo u lartësua kujtimi për dëshmorët e heronjtë dhe për pishtarët e dijes e arsimit duke dëshmuar se i përjetshëm mbetet respekti dhe kujtimi për ta.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësen dhe veprimtaren sindikale Nora Ajeti

Klasa nuk do të ishte një vend edukimi pa një mësues të mrekullueshëm



Nora Ajeti është mësimdhënëse në shkollën “Dardania” në Prishtinë, por është edhe veprimtare sindikale. Ajo është dëshmuar me njohuri të larta edhe në aktivitete për ngritjen profesionale të mësimdhënësve. “Duhet të gjithë të angazhohemi për më shumë përgjegjësi, llogaridhënie dhe transparencë, në mënyrë që të arrihen ndikime afatgjate në të ardhmen e zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës”, shprehet veç tjerash, Nora në intervistën për gazetën tonë.

Arsimimi sot:

Kush është Nora Ajeti?

Nora:

Jam mësimdhënëse e ciklit klasor ku shkollën fillore, të mesme, universitetin dhe studimet pasuniversitare i kam kryer në Prishtinë. Gjatë jetës sime kam punuar në fusha të ndryshme, duke filluar si personel shëndetësor, eksperte tereni në organizatat e huaja joqeveritare, para dhe gjatë luftës sonë në vend, si menaxhere e Zyrës së projekteve të financuara nga BE, menaxhere e Zyrës së projektit të BE-së për zhvillimin profesional të mësimdhënësve (0-5), trajnere e modulit “Roli i mësimdhënësve në mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës”, “Edukimi dhe menaxhimi mjedisor në arsimin parauniversitar”. Jam mësimdhënëse e ciklit klasor në shkollën “Dardania” në Prishtinë.

Arsimimi sot:

Cili është arsimi sot në Kosovë?

Nora:

Arsimi në Kosovë realizohet në institucione publike dhe private. Duke filluar nga viti 1999 arsimi në Kosovë iu nënshtrua reformave në të gjitha nivelet: nga arsimi parashkollor deri në nivelin universitar. Këto reforma synonin përshtatjen e arsimit në Kosovë sipas standardeve bashkëkohore evropiane dhe botërore. Sfera e Arsimit për vite me radhë është përballur me probleme të mëdha dhe pa përmirësim të duhur në fusha të caktuara. Institucionet e vendit duhet kontribuar me ndarje kritikuar për mos ndarje të mjaftueshme të mjeteve financiare dhe projekteve adekuate për arsimin. Pakënaqësitë e mësimdhënësve sa i përket pagave dhe ndërhyrjet në institucionet e pavarura arsimore janë vetëm disa nga problemet me të cilat u përball sektori i arsimit në Kosovë gjatë viteve të kaluara.

Arsimin në Kosovë po e përcjellin dukuritë negative të cilat janë prezente edhe në shoqërinë në Kosovë. Duhet të gjithë të angazhohemi për më shumë përgjegjësi, llogaridhënie dhe transparencë në mënyrë që të arrihen ndikime afatgjate në të ardhmen e zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës.

Investimi në burimet njerëzore, gjegjësisht në kuadrin arsimor si dhe në infrastrukturën adekuate së bashku me përcjelljen e trendeve në sektorin e teknologjisë informative është rruga më adekuate për sanimin dhe përmirësimin e gjendjes aspak të lehtë në fushën e arsimit në vendin tonë.

Duke pas parasysh se e ardhmja dhe mirëqenia shoqërore është drejtpërdrejtë e lidhur dhe e përcaktuar prej arsimit cilësor, atëherë është me prioritet të lartë dhe pa humbje kohe marrja e hapave në këtë çështje.

Arsimimi sot:

Cili është aktiviteti juaj sindikal?

Nora:

Aktiviteti sindikal nëpërmes organizatave gjegjëse sindikale që janë të pavarura nga shteti dhe partitë politike, demokratike, jo-fitimprurëse që përfaqësojnë interesat e të punësuarve në institucionet publike dhe private të arsimit, shkencës dhe kulturës, me anëtarësim vullnetar. Reflektohet duke përkrahë dhe mbrojtur interesat e tyre ekonomike dhe statusin social, të drejtat e punëtorëve dhe anëtarëve të SBASHK-ut dhe duke shpreh qëndrimet e veta lidhur me ngjarjet karakteristike, sociale në vendin tonë dhe në botë.

Në këtë kontekst, edhe unë si anëtare e SBASHK-ut jap kontributin tim në këto parime, veçanërisht në zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

Arsimimi sot:

Cili është roli i gruas në organizimin sindikal?

Nora:

Roli i gruas në organizimin sindikal është kyç dhe tejet domethënës. Në një mënyrë është edhe tregues real i gjendjes dhe pozitës së gruas në shoqëri. Edhe pse pjesëmarrja e gruas në forume dhe trupa të sindikatave është në rritje e sipër, ende ka hapësirë dhe është e domosdoshme që pjesëmarrja dhe ndikimi në vendimmarrje të jetë sa më i lartë, në mënyrë që grua të jetë prezente dhe aktere në organizimet sindikale e po ashtu edhe në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.

Arsimimi sot

Mesazhi juaj për koleget dhe kolegët kudo janë.

Nora

Mesazhi për kolegët mësimdhënës. Mesazhi për mësimdhënësit do ishte të vazhdojmë kontributin tonë për avancimin e një ndër profesioneve më fisnike dhe të dashura, me përkushtim e dashuri, për të dhënë dituri dhe edukim brez pas brezi, në këtë mënyrë të japim

kontribut në shoqërinë tonë.

Të mos harrojmë se një klasë mund të mbijetoj pa një kompjuter ose një iPad, por kurrë nuk do të ishte një vend ku edukohet pa një mësues të mrekullueshëm.


Çdo ditë është dita e duhur për t'ia shprehur mirënjohjen mësuesit për punën e mundimshme që ai bën. Mësuesi ka nevojë të ndihet i vlerësuar.

Gjatë muajit

Takimet e rregullta me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve

Qëndrime unike për përballje me sfidat e kohës

Edhe në muajin nëntor janë mbajtur takime e konsultime të rregullta me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe



të Universiteteve për të bashkëbiseduar për çështje me rëndësi dhe për të marrë vendime të përbashkëta lidhur me angazhimet dhe aktivitetet e përditshme. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë dhënë informacione lidhur me situatën aktuale dhe për sfidat e paraqitura gjatë muajit nëntor. Pas kësaj pjesëmarrësit në takime kanë bashkëbiseduar dhe kanë treguar për aktivitetet në komunat e tyre dhe në Universitete duke u ndalur edhe

te çështja e regjistrimit në eKosova. Ata kanë treguar për vështirësitë e paraqitura, por edhe për rrjedhën e regjistrimit në këtë vegëz duke theksuar se hetohet një shtim i vazhdueshëm i të regjistruarve në këtë platformë dhe kjo dëshmon se tendencat për ta zverdhur unitetin në SBASHK, nga kushdo qofshin ato, janë të gjykuara të dështojnë.

Në njërin nga këto takime është biseduar edhe për informatën e Ministres Nagavci me tendencën për të shkëputur njëanshëm Kontratën Kolektive të Arsimit. Kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve kanë marrë qëndrim të përbashkët se kjo informatë e ministres lidhur me Kontratën është e papranueshme dhe se nenet e caktuara të Kontratës e thonë qartë se as njëra palë nënshkruese nuk mund të bëjë shkëputje të njëanshme dhe prandaj Kontrata Kolektive e Arsimit vazhdon të mbetet valide dhe e vlefshme. SBASHK-u do të konsultohet me ekspertë të fushës juridike dhe do të merr me kohë hapa të duhur lidhur me mbrojtje të Kontratës Kolektive të Arsimit që është nënshkruar më 21 janar 2021 nga MASHTI dhe SBASHK-u.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takuan me zv/ministrin Pupovci

Bashkëbisedë për situatën aktuale në arsim

Duke dëshmuar se i kushton rëndësi meritore dialogut, SBASHK-u i ka dërguar ftesë për takim ministres së arsimit, Arbërie Nagavci. Nga kabineti i saj janë deklaruar se Ministrja atyre ditëve ka shumë aktivitete të parapara e të planifikuara me kohë dhe me mirësi janë lutur për mirëkuptim në mënyrë që takimi të mbahet me zv/ministrin Dukagjin Pupovci.

Në këtë takim SBASHK-u është përfaqësuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Kryetari Jasharaj në fillim të këtij takimi ka falënderuar zv/ministrin Pupovci për qëndrimin korrekt dhe deklaratat e matura gjatë gjithë grevës, gjë e cila, siç tha Jasharaj, nuk mund të thuhet edhe për ministren dhe ca përfaqësues të tjerë të institucioneve.

Pas kësaj nënkryetarja Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

kanë prezantuar kërkesat dhe angazhimet e SBASHK-ut duke përmendur kërkesën e mundësive që në Buxhet të parashihen kërkesat nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës, pasi që është duke u punuar Udhëzimi Administrativ për formulën e financimit në arsim. Ata kanë cekur edhe çështje lidhur me Ligjin e pagave

duke uruar që ai të shkojë sa më shpejt në Parlament dhe që të jetë një ligj që respekton kërkesat legjitime të anëtarësisë së SBASHK-ut.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë informuar zv/ministrin edhe për pengesat që ka krijuar eKosova dhe për defektet e shumta që ka kjo platformë e duke kërkuar që MASHTI të angazhohet që të mbahet një takim i përgjegjësve të eKosova me përfaqësues të SBASHK-

SBASHK zhvilloi aktivitete në Skenderaj e Suharekë

U rifillua me trajnimet bazuar në kërkesat e anëtarësisë

Kërkesat e arritura nga koleget dhe kolegët tanë përmes kryetarit të Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Skenderajt, Ramiz Polaci kanë bërë që stafi qendror të rinis me organizimin e trajnimeve. Trajnimi “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, i udhëhequr nga trajneri prof. dr. Hysen Sogojeva ka filluar më 5 nëntor në shkollën “Shaban Jashari për të vazhduar edhe për tri ditë të tjera.



Në hapje të këtij aktiviteti kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunën e Skenderajt, Ramiz Polaci ka falënderuar stafin e SBASHK-ut për angazhimet e shumta dhe ka vlerësuar se trajnimi që po organizohet këtu nga rëndësi të veçantë ngase u ofron dije të reja punëtorëve arsimor lidhur me udhëheqjen dhe planifikimin strategjik në institucionet e arsimit.



ut me qëllim të evitimit të këtyre pengesave e defekteve. Në këtë takim zv/ministri Pupovci në bashkëbisedën me përfaqësuesit e SBASHK-ut ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në shërbim të arsimit dhe është shprehur se do të komunikojë me zyrtarë përgjegjës nga eKosova me kërkesën që ata ta kenë një takim me përfaqësues të SBASHK-ut.

Trajneri Sogojeva ka përgëzuar SBASHK-un për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe është shprehur i sigurt se ky aktivitet do të jetë i suksesshëm dhe se pjesëmarrësit nuk do të jenë shikues po pjesëmarrës aktiv gjatë gjithë katër ditëve të këtij trajnimi. Pjesëmarrësit kanë falënderuar SBASHK-un për gjithë angazhimet dhe kanë shprehur respekt edhe për trajnerin të sigurt se ai do të bartë gjithë njohuritë e duhura nga ky trajnim, e të cilat njohuri do të jenë një bazë e mirë për angazhimet e pjesëmarrësve në detyra konkrete të udhëheqjes në institucionet arsimore.



Po të shtunën e 5 nëntorit në shkollën “Sadri Duhla” të komunës së Suharekës është mbajtur aktiviteti i vlerësimit të njohurive të arritura nga pjesëmarrësit në trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë qenë edhe kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunë e Suharekës Nazmi Gashi dhe trajnerja Bahrie Elshani.



Për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti është përkujdesur koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri i ndihmuar nga anëtarët e stafit qendror Albina Arifi, Nezafete Jakupi e Afërdita Ahmeti.

Takim i SBASHK-ut me Sindikatat e arsimit të Maqedonisë dhe Shqipërisë **Gatishmëri për aktivitete të përbashkëta sindikale**

Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë vazhdon me angazhimet me qëllim që të ndihmojë sindikatat e arsimit në rrugëtimin e tyre dhe në përballjen me sfidat e kohës e duke qenë vazhdimisht në shërbim të anëtarësisë. Në kuadër të këtij aktiviteti u zhvillua një seminar tre ditor në Ohër për udhëheqës sindikal të arsimit në Maqedoni. Në pjesën e parë të këtij aktiviteti ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë dhe të SBASHK-ut.

Udhëheqësi i zyrës së Qendrës Amerikane të Solidaritetit në Tiranë, Steven McCloud ka përgëzuar përfaqësuesit e sindikatave të arsimit në këtë aktivitet dhe pastaj ka treguar për angazhimet e Qendrës për të ndihmuar sindikatat e këtyre shteteve në forcimin e rolit të tyre përmes aktiviteteve të përbashkëta. Pas kësaj kryetari i Sindikatës së Arsimit të Maqedonisë së Veriut, Joakim Nedelkov ka përshëndetur mysafirët nga Shqipëria e Kosova duke kujtuar se këto sindikata kanë bashkëpunim të vazhdueshëm me sindikatën që ai përfaqëson. Kryetari Nedelkov pastaj ka pasqyruar rrugëtimin e Sindikatës së Arsimit të Maqedonisë duke

përmendur sfidat e shumta dhe arritjet në shërbim të anëtarësisë.

Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, Nevrus Kaptelli ka falënderuar z. Steven dhe stafin e tij për angazhimet në mbështetje të organizimit sindikal dhe është shprehur i gatshëm që të vazhdohet me aktivitetet e përbashkëta me qëllim që sindikatat e arsimit në këto tri shtete të ndihmohen e këshillohen për forcimin e rolit të tyre në shërbim të anëtarësisë.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala, koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe kryetaren e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit të Mesëm të Lartë dhe anëtare e kryesisë së SBASHK-ut Hanife Salihu kanë treguar për angazhimet e SBASHK-ut, për sfidat me të cilat po përballen duke shprehur gatishmërinë për pjesëmarrje aktive në aktivitetet që do të organizohen nga Qendra e Solidaritetit duke u nisur edhe nga seminari që planifikohet më mbahet me veprimtarë sindikalë të SBASHK-ut në pjesën e parë të vitit 2023.



SBASHK në Kongresin e Sindikatës së Arsimit të Sllovenisë **Vazhdon bashkëpunimi dhe miqësia e krijuar në vitet e vështira**

Sindikata e Arsimit, Shkencës e Kulturës e Sllovenisë (SVIZ) ka mbajtur Kongresin e saj në qytetin e bukur bregdetar Portorozh. Pjesë e kësaj ngjarje të veçantë të arsimit slloven, krahas shumë delegacioneve sindikale, ishin edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut duke dëshmuar se vazhdon bashkëpunimi dhe miqësia e krijuar në vitet e vështira. Sindikalistët slloven i ka nderuar me pjesëmarrjen dhe me fjalën përshëndetëse në Kongres drejtorja e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) Susan Flocken.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Para fillimit të Kongresit kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar me sekretarin e përgjithshëm të SVIZ dhe mikun e madh të SBASHK-ut Branimir Shtrukel me të cilin kanë bashkëbiseduar për gjendjen në arsimin slloven dhe atë të Kosovës e duke u ndalur te sfidat dhe angazhimet aktuale. Ata kanë falënderuar mikpritësin për ftesën dhe për angazhimet e tij në cilësinë e nënkryetarit të ETUCE në mbështetje e përkrahje për SBASHK-un.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar edhe me drejtoreshën e përgjithshme të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Susan Flocken duke e informuar për

rrjedhat aktuale në arsimin e Kosovës dhe për sfidat e shumta që po përballët SBASHK-u. Ajo është shprehur se falënderon SBASHK-un për informatat me kohë për gjithë situatën aktuale dhe ka shtuar se gjithë shqetësimet e ngritura janë prezantuar në organet e ETUCE-s, por edhe në komisionet gjegjëse në BE. Ajo ka shprehur kundërshtimin e saj edhe ndaj një njoftimi të MASHTI-t për idenë e pamatur e të padrejtë lidhur me Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës. Drejtorja Flocken ka ripërsëritur mbështetjen e ETUCE-së për SBASHK-un në përballje me çdo sfidë. Duke treguar respektin për mysafirët e shumë mikpritësi ka organizuar vizitë për ta në Shpellën e Postonjës, që është i njohur kudo në Evropë si pasuri e madhe turistike e Sllovenisë.



Gjatë qëndrimit në Portorozh delegacioni i SBASHK-ut hasi në befasi të këndshme duke pasur takime të rastit me shqiptarë të Kosovës, që po punonin në këtë qytet bregdetar. Ata dëshmuar se nuk kanë harruar mikpritjen shqiptare dhe kaluar qaste të bukura e në bashkëbiseda për jetën në Slloveni dhe për mallin që kanë për vendlindjen e tyre.

Nga takimi i kryetarit të BSPK-së Hykolli me kryeministrin Kurti **Bashkëbisedë për kërkesat e Federatave sindikale**



Më 8 nëntor kryetari i BSPK-së Atdhe Hykolli është takuar me Kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Kryetari Hykolli pas kësaj ka njoftuar anëtarët e Kryesisë ekzekutive të BSPK-së me rrjedhën e këtij takimi. Kryetari Hykolli në këtë informatë ka cekur se: “Në vazhden e takimeve të BSPK-së më 8 nëntor 2022

u mbajt takimi me përfaqësuesin e Partnerit Social – Qeverisë, Kryeministrin z. Albin Kurti. Takimi u zhvillua në Ndërtesën e Qeverisë dhe në takim ishte i pranishëm edhe Shefi i Kabinetit të KM, z. Luan Dalipi. Në takim u bisedua për qartësimin e kërkesave të parashtruara tashmë, dhe përmbushjen sa më të shpejtë të tyre. Theks i veçantë u vu për kuotozacionin e anëtarësisë dhe gjetjen e zgjidhjes së duhur dhe të shpejtë për regjistrimin e anëtarësisë. Po ashtu u bisedua edhe për përmbylljen e skicimit të projektligjit të pagave e sidomos për shqyrtimin dhe analizën e komenteve të dhëna nga përfaqësuesit e BSPK-së.

Pika tjetër me rëndësi e diskutimit ishte edhe përgatitja e pakos së re mbështetëse për përballje me inflacionin



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

në vitin 2023 për të gjithë të punësuarit në Sektorin Publik. Në takim u bisedua edhe për Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive e cila duhet të negociohet dhe të nënshkruhet sa më shpejtë.

Përfaqësuesi i Partnerit Social – Qeverisë, Kryeministri më informoi se në Qeveri kanë arritur rreth 2000 komente në ligjin e pagave të cilat janë duke u shqyrtuar dhe duke u analizuar që të mund të bëhen pjesë e tekstit përfundimtar të projektligjit të pagave i cili së shpejti do të dërgohet për miratim në Kuvendin e Kosovës. Për çështjen e pakos mbështetëse për përballje me inflacionin në vitin 2023 për të gjithë të punësuarit në Sektorin Publik pritet veprimi i duhur. Ndërlidhur me

këtë Kryeministri më informoi se Qeveria është duke u munduar të gjejë zgjidhjen e duhur për të përkrahur familjet duke ua rimbursuar kilovatët e shpenzuar dhe për këtë do të ndajë një shumë të konsiderueshme nga Buxheti i Kosovës.

Për Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive mbet që në KES të saktësohet kjo dhe dokumenti përfundimtar t'i paraqitet Qeverisë për nënshkrim. Çështja e kuototizacionit e cila ka çrregulluar funksionimin e Federatave po edhe të BSPK-së mbeti që brenda javës Shefi i Kabinetit z. Luan Dalipi të kontaktojë Zyrën e Financave për të gjetur zgjidhjen e duhur të regjistrimit të anëtarësisë sindikale”.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture